



REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ  
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1569/Prot.  
12

Tiranë, më 11.07.2019

VENDIM SENATI

Nr. 56, datë 11.07.2019

PËR MIRATIMIN “RREGULLORE PËR SJELLJEN ME INTEGRITET NË  
KËRKIMIN SHKENCOR DHE PROMOVIMIN AKADEMIK  
NË UBT”

Në përputhje me ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e UBT-së, Urdherin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 105, dt. 23.02.2012 “Për Miratimin e Rregullores “Për Etikën në Veprimtarinë Kërkimore dhe Botuese”, si dhe vendimin e Rektoratit nr. 51, dt. 02.07.2019 në mbledhjen e tij të datës 11.07.2019, Seanti Akademik

V E N D O S I:

1. Të miratohet “Rregullore për Sjelljen me Integritetin në Kërkimin Shkencor dhe Promovimin Akademik në UBT” (bashkëngjitur rregullorja).
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Prof. Dr. Sulejman Sulçe, zv. Rektor për Kërkimin Shkencor, Prof. Asoc. Remzi Keco, zv. Rektor për problemet e Mësimit, Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional, dekanët e fakulteteve, përgjegjësat e departamenteve dhe Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Senatit

Prof. Dr. BARI MUSA BAHMIU





REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
UNIVERSITETI BUJQÉSOR I TIRANËS  
REKTORATI

Miratohet:

REKTORI

Prof. Bari Musabelli



RREGULLORE

PËR

SJELLJE ME INTEGRITET NË KËRKIMIN SHKENCOR & PROMOVIMIN  
AKADEMIK  
NË UNIVERSITETIN BUJQÉSOR TË TIRANËS

Tiranë, Korrik 2019



## PERMBAJTJA:

Neni 1: Dizajni i logoit	1
Neni 2: Objektet e kujtimit	2
Neni 3: Gjilani i kujtimit	3
Neni 4: Prezantimi	5
Neni 5: Përmalitje	6
Neni 6: Përgjegjësia e kujtimit	6
Neni 7: Kujtimi i bazuve te reperimtarisë kujtimit	7
Neni 8: Formular i procedurave te kujtimit	8
Neni 9: Rezultati dhe mësimdhënës i kujtimit	9
Neni 10: Përgjegjësia e permbajtjes	10
Neni 11: Shkelje e rendit të integratit në kujtimin e tikanë	10
Neni 12:	10
Shkelje të tjera të integratit në kujtimin e tikanë	11
Neni 13: Subjekti që nënshtrohen falasitëm, tubikimi të tij me vnde të magjistaret	11
Neni 14: Monitorimi dhe vlerësimi i përmalitje kujtimit	12
Neni 15: Procedurat e vlerësimit te dokumenteve per plagjiatë, falashim dhe fabrikim e tij dienave	12
Neni 16: Penalitet per doktorantin	13
Neni 17: Penalitet per botimet akademike e kujtimit	13
Neni 18: Procedura e ankesave	14
Neni 19: Trajtimi i Ankesave dhe Nini i e Përgjegjësive	14
Neni 20: Procedura te përzgjidhjes se Komisioneve	15
Neni 21: Komisionet Autoriteti Përgjegjësimi	15
Neni 22: Procedura pasuese	16
Neni 23: Mbrotja e paleve te perftira	16
Neni 24: Data e hyrjes ne fugu	17
Neni 25: Dispozitat perfundimare	17



### Neni 1: Baza ligjore

Kjo rregullore bazohet në:

1. Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nen 33/3;
2. Ligji Nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", nen 1 e në vijim;
3. Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar me ligjin nr. 9475, datë 09.02.2006; me ligjin nr. 9529, datë 11.05.2006; me ligjin nr. 86/2012 datë 18.09.2012 dhe me ligjin nr. 44/2014, datë 24.04.2014.
4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 777, datë 26/12/2018 "Për kontrollin antiplagjaturë të disertacioneve përfitimin e gradave shkencore"
5. Urdhëri i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 105 datë 23.03.2012 përmiratimin e rregullores "Për etikën në veprimtarinë kërkimore dhe botuese"
6. Statuti i Universitetit Bujqësor të Tiranës, nen 62, viti 2018.

### Neni 2: Objekti i Rregullores

7. Rregullorja për Sjellje me Integritet në Kërkimin Shkencor në Universitetin Bujqësor të Tiranës, përban parimet dhe normat themelore të sjelljes së njësive përbërse të tij, si edhe personelit të tyre akademik ose kërkues shkencor, në përpunje me Kodin Evropian të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor.

### Neni 3: Qëllimi i rregullores

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është:
  - a. Sigurimi i standardeve etike të domosdoshme përkim shkencor.
  - b. Sigurimi i një kornize vetërregulluese për ushtrimin dhe mbajtjen e përgjegjësive ligjore, institucionale, profesionale, morale e shoqërore të njësive bazë dhe kryesore dhe të pjesëtarëve të komuniteteve respektive, akademike e shkencore lidhur me etikën në kërkimin shkencor.

### Neni 4: Premisa

1. Premisa e rregullores për Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor, niset nga premisa se kërkimi shkencor është një ndërmarrje e përbashkët, që kryhet në institucionet kërkimore e akademike, në qendrat kërkimore, në industri apo në mjetet e tjera.
2. Kërkimi përfshin bashkëpunimin, e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të njësive, grupeve mësimore dhe kërkimore dhe individëve, i cili ushton ndikim në zhvillimin ekonomik, social, politik dhe kulturor të vendit.

### Neni 5: Përkufizime

Termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptimet si më poshtë:

1. "Kërkim shkencor" quhet puna krijuese e ndërmarrë dhe e realizuar në mënyrë sistematike, që ka përqelli shtimin dhe zhvillimin e njohurive shkencore (Urdhëri i MASH nr. 105, datë 23/03/2012)
2. "Kërkim themelor" quhet puna origjinale teorike dhe/ose eksperimentale e ndërmarrë, përfshimin e njohurive të reja, pa pasur pikësynim të drejtëshkërtuar ndonjë zbatim ose përdorim praktik të saj. Ky lloj i kërkimit që e përfshin veprimtarinë kërkimore, dallohet nga kërkimi i zbatuar. (Urdhëri i MASH nr. 105, datë 23/03/2012)



3. "Kërkim i zbatuar" quhet puna origjinale kërkimore e ndërmarrë për të zgjidhur problemet specifike të përdorimit praktik. Dallohet nga kërkimi themelor, sepse nuk synon përfshimin apo prodhimin e njohurive të reja të përgjithshme. (*Urdhëri i MASH nr. 105, datë 23/03/2012*)
4. "Zhvillim eksperimental" quhet puna sistematike e mbështetur mbi njohuritë ekzistuese të fituara nga kërkimi themelor, apo i zbatuar dhe mbi të dhënat shkencore, e orientuar drejt prodhimit të produkteve apo të pajisjeve të reja dhe që ka për qëllim njohjen, studimin, zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre. (*Urdhëri i MASH nr. 105, datë 23/03/2012*)
5. "Veprimitari kërkimore" quhet kërkimi logjik dhe sistematik i informacioneve të reja dhe të dobishme me synim gjetjen e përgjigjeve për pyetjet që lindin dhe të zgjidhjeve të problemeve në fusha të ndryshme të shkencës nëpërmjet analizave objektive dhe përdorimit të metodologjisë së duhur shkencore.
6. "Bashkautorësia" është kryerja e një punimi në grup, me më shumë se një anëtar.
7. "Botim grabitqar" është botimi që dëmontrueshëm dhe pengon kontrollin e cilësisë së kërkimit shkencor.
8. "Fabrikimi" është sajimi i rezultateve të kërkimit dhe regjistrimi i tyre sikur të ishin të vërteta.
9. "Falsifikimi" është manipulimi i materialeve, pajisjeve dhe/o se proceseve të kërkimit, ndryshimi, heqja osh shmangja e të dhënavë ose e rezultateve, në mënyrë të pajustifikuar.
10. "Plagjiatura" është përdorimi i ideve dhe punës së të tjera si të vetat, pa cituar burimin original, duke shkelur të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale. Si e tillë, plagjiatura përfshin:
  - Citimet e drejtpërdrejta pa cituar referencën, të dhëna, ilustrime, tabela të një personi tjetër, pa autorizimin e duhur të burimit.
  - Kopjimi i një pjese të librave/artikullit/raportit/monografisë/ disertacionit /tezës pa citim të duhur.
  - Blerja, vjedhja ose huazimi i detyrave, eksperimenteve / rezultateve.
  - Paragjykim i punës së të tjera pa autorizimin e duhur.
  - Përdorimi i ideve të dikujt tjetër pa cituar originalin.
  - Kopjimi, prerja dhe ngjitja nga interneti ose burimi online dhe dorëzimi si punë e vet pa dhënë referenca /citim të duhur.

#### Neni 6: Përgjegjshmëri në kërkim

1. Universiteti, fakultetet, departamentet dhe GMK para çdo kërkimi detyrohen të bëjnë trajnimin e personelit, sidomos për doktorantët, për etikën në kërkim.
2. Në këto aktivitete trajnuese që mund të janë konferanca, seminare apo ditë informimi, ofrohet informacion për metodat e kërkimit, etikën në kërkim, konfidencialitetin, drejtimin e kërkimit, ruajtjen e të dhënavë.
3. Institucioni ka të drejtë të nënshkruajë marrëveshje për trajnime të përbashkëta me institucionë të tjera.
4. Institucioni/departamentet respektive, ka detyrë të informojë të gjithë personelin akademik, përfshirë studentët e programeve Master dhe Doktoratë, përcaktimet dhe parashikimet e kësaj Rregulloreje dhe t'ju vendosë atyre në dispozicion këtë dokument së bashku me pasqyrat anekse.

#### Neni 7: Krijimi i bazës së të dhënavë të veprimitarisë kërkimore

1. Universiteti dhe paralelisht me të Njësitetë Kryesore dhe Departamente krijojnë



Neni 9: Respekti dhe masat mbrojtëse në kërkimin shkencor

1. Kërkuesit veprojnë në përputhje me kodet dhe rregulloret e disciplinave përkatëse të fushave të studimit.
  2. Kërkuesit i trajtojnë subjektet e kërkimit, qofshin këto njerëzore, shtazore, kulturore, biologjike, mjedisore, fizike, historike, me kujdes e respekt dhe në përputhje me dispozitat ligjore dhe etike në fuqi.
  3. Kërkuesit tregojnë kujdes maksimal për shëndetin, sigurinë, integritetin, dhe mirëqenien e komunitetit, të bashkëpunëtoreve dhe të personave të tjera që marrin pjesë ose që janë të lidhur me kërkimin.
  4. Protokollet, metodologjitet dhe teknikat e kërkimit respektojnë ndjeshmëritë që lidhen me diferencat moshore, gjinore, seksuale, kulturore, fetare, etnike, ekonomike, financiare dhe sociale midis komuniteteve, individëve, bashkëpunëtoreve dhe të personave të tjera që marrin pjesë, ose që janë të lidhur me kërkimin.
  5. Kërkuesit shhangin rrëzjetet dhe dëmet e mundshme që kërkimi mund të shkaktojë mbi komunitetet, individët, mjedisin, trashëgiminë historike e kulturore, si dhe perspektivat e zhvillimit në territorin ku kryejnë studimet.

#### Neni 10: Përgjegjësia e përbashkët

1. Të gjithë bashkëpunëtorët në studimet e përbashkëta marrin përgjegjësi për garantimin e integritetit gjatë gjithë fazave të procesit kërkimor.
  2. Të gjithë bashkëpunëtorët në studimet e përbashkëta bien dakord qysh në fillim mbi qëllimet e punës kërkimore dhe komunikimin mbi procesin dhe rezultatet e kërkimit në mënyrë sa më transparente e të hapur.
  3. Të gjithë bashkëpunëtorët në studimet e përbashkëta bien dakord qysh në fillim mbi standarde týrë integritetin e procesit kërkimor, mbi ligjet dhe rregulloret që do të zbatohen, mbi mbrojtjen e së drejtës së autorit për bashkëpunëtorët, si dhe mbi procedurat e trajtimit të mosmarrëveshjeve në rastet e shkeljeve të dispozitave të Kodit të Sjelljes për Integritet në Kërkimin Shkencor.
  4. Të gjithë partnerët në studimet e përbashkëta bien dakord qysh në fillim mbi dërgimin ose jo për botim të rezultateve të kërkimit.

Nepj 11: Shkeljet e rënda të integritetit në kërkimin shkencor

Shkelje të rëndë të integritetit në kërkimin shkencor përbëjnë, fabrikimi, falsifikimi, plagiatura dhe pranimi dhe/ose paraqitura e punimeve pranë një organi haptazi iokompetent ose të paautorizuar në fushën përkatëse.

Neni 12. Shkelje të tjera të integritetit në kërkimin shkencor

- I. Shkelje të integritetit në kërkimin shkencor, përbjënjë praktikat e mëposhtme:

  - Manipulimi i autorësisë ose denigrimi i rolit të kërkuesve të tjera në botime;
  - Ribotimi i pjesëve thelbësore të botimeve të veta më të hershme si të reja (autoplajtiatura);
  - Citimi përgjedhës, me qëllim për të zmadhuar gjetjet e veta ose të redaktorëve, drejtuesve ose të kolegëve;
  - Fshehja e pjesëshme e rezultateve të kërkimit;
  - Lejimi i financuesve/sponsorizuesve të prezkojnë pavarësinë e procesit të kërkimit ose të raportimit të rezultateve, me qëllim krijimin e kuptimeve të njëanshme ose të paplota;
  - Zgjerimi në mënyrë të panevojshme i bibliografisë së studimit;



- bazën elektronike të të dhënavë të veprimtarisë kërkimore, ku ruhen rezultatet e kërkimit.
2. Baza e të dhënavë të veprimtarisë kërkimore ngrihet në nivel universiteti
  3. Njësie kryesore dhe departamenti, kur shihet e nevojshme dhe plotësohen kriteret e menaxhimit të të dhënavë nga ky i fundit.
  4. Universiteti dhe njësia kryesore siguron:
    - a. Mjedise të sigurta për ruajtjen e të dhënavë të veprimtarisë kërkimore dhe të dhënavë parësore të veprimtarisë kërkimore të tilla si: fletoret e laboratorit dhe të dhënat e analizuara të kërkimit.
    - b. Mbrotjtjen e së drejtës së autorit në veprimtarinë kërkimore.
    - c. Ruajtjen e të dhënavë të veprimtarisë kërkimore, duke përfshirë të dhënat elektronike, në një formë të qëndrueshme, të indeksuar dhe të aksesueshme nga kërkuesit e interesuar.
    - d. Të dhënat janë pronë e kërkuesit/kërkuesve, departamentit përkatës dhe organizmave financuese të parashikuara në kontratat paraprake midis kërkueseve/ departamentit dhe këtyre të fundit duke respektuar në mënyrë strikte të drejtës së autorit/autorëve, sipas Ligjit të së drejtës së autorit.

#### **Neni 8: Parimet e procedurave të kërkimit shkencor**

1. Në një kërkim shkencor, pyetjet kërkimore dhe hipotezat mbështeten në kontekstin dhe nevojat e zhvillimit shoqëror.
2. Kërkuesit bëjnë kujdesin më të madh të mundshëm për mënyrat dhe procedurat e analizës, të dokumentimit dhe të formulimit të rekomandimeve të kërkimit shkencor.
3. Kërkuesit përdorin në mënyrë racionale, me përgjegjësi dhe vetëdije të lartë fondet e kërkimit shkencor.
4. Rezultatet, interpretimet, përfundimet dhe rekomandimet e kërkimit shkencor publikohen të qarta, me saktësi e transparencë, duke respektuar fshehtësinë e të dhënavë apo të gjetjeve, kur kjo është e nevojshme, ose kur kërkohet.
5. Kërkuesit raportojnë rezultatet e kërkimeve me standartet e kërkuar dhe atje ku është e zbatueshme, në mënyrë që të jenë të verifikueshme.
6. **Parimi i garancisë** - do të kuptojmë garancitë për cilësinë e kërkimit, pasqyruar në konceptin, metodologjinë, analizën dhe përdorimin e burimeve të ndryshme.(Kodi european i sjelljes për integritet në kërkimin shkencor)
7. **Parimi i ndershmërisë** – do të kuptojmë ndershmëri në zhvillimin, ndërmarrjen, shqyrtimin dhe komunikimin e kërkimit në një mënyrë transparente, të drejtë, të plotë dhe të paanshme, që prej fazave fillestare, deri në përfundimin dhe bërjen publike të rezultateve dhe më tej – për ruajtje nën kujdestari e të dhënavë dhe e kampionëve fizikë edhe pas botimit të punimit. (Kodi european i sjelljes për integritet në kërkimin shkencor)
8. **Parimi i respektit** – do të kuptojmë respektin kundrejt kolegëve, pjesëmarrësit në kërkim, shoqërinë, ekosistemet, dhe mjedisin. (Kodi european i sjelljes për integritet në kërkimin shkencor)
9. **Parimi i përgjegjshmërisë** – do të kuptojmë marjen përsipër të përgjegjësisë për kërkimin e realizuar që nga ideja deri në botim, për menaxhimin dhe organizimin e tij, mbikëqyrjen e udhëheqjen, dhe për impakte me të gjera. (Kodi european i sjelljes për integritet në kërkimin shkencor)



- g. Akuzimi me keqdashje i studiuesve të tjerë për sjellje të papranueshme ose shkelje të tjera;
- h. Zmadhimi i pajustifikuar i rëndësisë dhe i zbatueshmërisë praktike të gjetjeve të kërkimit;
- i. Vonimi ose pengimi i punës së kërkuesve të tjerë;
- j. Keqpërdorimi i pozitës më të lartë për të inkurajuar shkelje të integritetit kërkimor;
- k. Fshehja e shkeljeve të mundshme të integritetit kërkimor të kryera nga persona të tjerë, ose qëndrimet e papërshtatshme ndaj sjelljeve që shkelin kodin e sjelljes për integritet në kërkimin shkencor, si dhe të shkeljeve të tjetra të kryera nga institucionet;
- l. Themelimi ose mbështetja e revistave a botimeve të tjetra grabitqare që minojnë kontrollin e cilësisë së kërkimit;
- m. Fshehja e konfliktit të interesit;
- n. Shkelje të tjetra etike të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi

**Neni 13: Subjektet që i nënshtrohen kontrollit për falsifikim, fabrikim të të dhënave dhe plagiaturës**

1. Të gjithë doktoratat që janë mbrojtur në Universitetin Bujqësor të Tiranës pas miratimit të VKM, dhjetor 2018 (VKM 777, datë 26.12.2018).
2. Të gjithë doktoratat që janë mbrojtur në Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe që është konfirmuar me shkrim autenticiteti i punës së kryer.
3. Të gjithë doktoratat, ndaj të cilëve konfirmohet një ankesë përmes një letre të nënshkruar, përbën padyshim një indicie që duhet të konsiderohet.

**Neni 14: Monitorimi dhe vlerësimi i veprimtarisë kërkimore**

1. Universiteti vlerëson veprimtarinë kërkimore të kryer nga kërkuesit shkencorë, jo vetëm për të matur përparimin e tyre në karrierën akademike, por edhe efikasitetin e fondëve të përdorura për kërkim në funksion të përmirësimit të politikave të kërkimit.
2. Institucioni kërkimor parashikon në politikat e tij ruajtjen e të dhënave dhe rezultateve të veprimtarisë kërkimore, si edhe të drejtën e konsultimit të tyre nga studiuesit e interesuar.

Përgjegjësitet e institucionit:

- a. Për vlerësimin e veprimtarisë shkencore universiteti mbështetet në komunikimin e rezultateve të kërkimit, në vazhdimësinë e veprimtarisë kërkimore të bazuar në këto rezultate dhe njohjen e ecurisë së veprimtarisë kërkimore nga pjesa tjetër e komunitetit shkencor;
- b. Universiteti monitoron veprimtarinë kërkimore, në afate kohore të përcaktuara në përpunim me veçoritë e saj, duke respektuar legjislacionin në fuqi;
- c. Universiteti përzgjedh Komisionin e Integritetit Akademik të Universitetit (KIAU, këtë e tutje) për vlerësimin e monitorimit. Komisioni do të ketë 7 anëtarë, një nga secili fakultet, një profesor i jashtëm i përzgjedhur nga rektori dhe Përgjegjësi i Zyrës së Kërkimit dhe Projekteve.
- d. KIAU-s i bashkohet një personel IT, pa të drejtë vote, për përpunimin teknik të dokumentave që do të vlerësohen.
- e. Anëtaret e KIAU përzgjidhen nga stafi akademik, në mënyrë të njëllojtë si edhe Komisionet e tjera të përherëshme të Universitetit. KIAU funksionon mbi bazën e një rregulloreje të përpiluar nga vet ai dhe e miratur nga rektori.
- f. Në secilin departament përzgjidhet Komisioni i Integritetit Akademik të



- Departamentit (KIAD, këtej e tutje).** KIAD zgjidhet me votë të fshehtë dhe në përbërje të tij janë personel akademik me integritetin më të lartë, dhe që kryesohet nga Përgjegjesi i departamentit.
- g. Në dobi dhe në funksion të trajtimit të problematikave që mund të lindin në Departamentet që nuk kanë KIAD, njësitë kryesore organizojnë **Komisionin e Integritetit Akademik të Fakultetit (KIAF)**.
  - h. Universiteti duhet të sigurojë sisteme kompjuterike të sigurta si dhe softëare të ngjashëm me ato që përdoren në vendet e BE (*check plagiarism software*), të mbështetura dhe të propozuara nga MASR. Universiteti garanton sigurinë e rrjetit dhe kontrollin e të drejtave të hyrjes në to. Softëare check plagiarism instalohet në departamente (KIAD), KIAU dhe Komisioni i Etikës së Universitetit.
  - i. Parashikohet ngritja e KIAU, ky nen ka mospërputhje me nenin 20 pasi tek nisi 14 komisioni përbëhet nga 7 anëtarë ndërsa tek nisi 20 përbëhet nga 5 anëtarë. Gjithashtu ka përplasje ndërmjet këtyre 2 neneve për përbërjen e komisionit.

#### Neni 15: Procedurat e vlerësimit të dokumenteve për plagiarizëm, falsifikim dhe fabrikim të të dhënave

1. Departamenti pasi ka një abonim të një *Plagiarism Check Software* dhe një indicie (për një pjestar të stafit të tij akademik) ose detyrim për vlerësim sipas subjekteve të lart cituara, merr përgjegjësinë për kontrollin e plagiaturës, falsifikimit dhe fabrikimit të çdo studenti doktorate.
2. Në rastin e disertacioneve të doktoratës, çdo student, para se të mbrojë tezën duhet te dorëzojë në Departament-KIAD dhe në KIA kopjen elektronike, së bashku me një kërkesë për vlerësim të orgjinalitetit dhe përputhmërisë. Vetëm pasi merr vlerësimin pozitiv (me shumicë votash nga dy komisionet) nga KIAD dhe KIA (një double plagiarism check), vazhdon procedurën e mbrojtjes.
3. Nëse ka kontestime për vlerësimin:
  - a. I interesuari bën ankesë në KIAU dhe ky i fundit e adreson kërkesën në KIAD/KIAF për gjykim dhe vlerësim.
  - b. Nëse i interesuari merr një vlerësim negativ në KIAD/KIAF, atëherë ai i drejtohet me ankesë KIAU, i cili merr vendim përfundimtar me shumicë votash.

#### Neni 16: Penalitete për doktoratat

1. Penalitetet në rastin e plagiaturës në paraqitjen e tezës dhe disertacioneve:
  - a. Për **ngashmëri në Nivelin Zero**: Ngashmëria midis dokumenteve është brenda limitit (jo më shumë se 10%), rezultatet janë origjinale në kontekstin e duhur dhe të gjitha burimet origjinale janë cituar siç duhet. Ngashmëria nuk është e një natyre të tillë që ndikon drejtpërdrejt në kërkimet origjinale të hulumtimit. Nuk kërkohet asnjë veprim i mëtejshëm. Komisioni KIAD autorizon vazhdimin e procedurës së doktoratës.
  - b. Për **plagiaturë të nivelit të ulët**: Kur plagiatura është rezultat i negligencës, ose pa qëllim për të mashtuar dhe ngashmëria midis dokumenteve jashtë kufirit (mbi 10% deri në 40%), atëherë Komisioni KIAD mund të rekomandojë që kandidati mund të lejohet ta rinisë punën me disertacionin dhe të bëjë rregullimet e kërkua brenda një periudhës kohore të përcaktuar që nuk i kalon 6 muaj.



- c. Për plagjiaturë të *nivelit mesatar*: Ngjashmëria midis dokumenteve është jashtë kufirit (mbi 40% deri në 60%). Komisioni rekomandon që kandidati të shfuqizohet nga dorëzimi i disertacionit dhe ta rishikojë atë për një periudhë njëvjeçare dhe do të lejohet ta paraqesë tezën pa përsëritjen e gabimeve të vërejtura në vlerësimin e parë dhe me një paralajmërim që të mos e përsërisë gabimin përsëri, përndryshe regjistrimi në programin e doktoratës do të anullohet.
- d. Për plagjiaturë në *Nivel të Lartë*: Dëshmi e qëllimshme dhe e planifikuar për të kopjuar punën e bërë nga dikush tjetër. Një sasi e madhe e të dhënave të marra nga puna e dikujt tjetër, kopjimi i tabelave, figurave, skemave, kopjimi pa asnje referencë. Synimi për të mashtruar është shumë i qartë. Ngjashmëria midis dokumenteve është jashtë kufirit (mbi 60%). Komisioni i rekandonton Fakultetit dhe Universitetit (zyrave respektive) të anulojë regjistrimin e kandidatit.

#### **Neni 17: Penalite të botimet akademike dhe kërkimore**

1. Për *Nivelin Zero* te Ngjashmëria: Ngjashmëria midis dokumenteve është brenda limitit (jo më shumë se 10%) për vendosjen rezultateve origjinale në kontekstin e duhur dhe të gjitha burimet origjinale janë cituar siç duhet. Ngjashmëria nuk është e një natyre të tillë që ndikon drejtpërdrejt në gjetjet originale të kërkimit. Vlerësimi është pozitiv.
2. Për plagjiaturë të *nivelit të ulët*: Kur plagjiatura është rezultat i neglizhencës ose pa qëllim për të mashtruar dhe ngjashmëria midis dokumenteve jashtë kufirit (mbi 10% deri në 40%), atëherë Komisioni mund t'i rekomandojë Departamentit që kandidatit t'i kërkohet të tjerhiqet dorëshkrimi, i paraqitur për botim.
3. Për Plagjiaturë e *Nivelit të Mesëm*: Dështimi për të përmendur citimet e duhura, duke kopjuar vetëm disa paragrafë. Qëllimi për të mashtruar është shumë i ulët dhe mund të jetë për shkak të mungesës së njohurive. Ngjashmëria midis dokumenteve është jashtë kufirit (mbi 40% deri në 60%), atëherë Komisioni mund t'i rekomandojë departamentit që kandidatit t'i kërkohet të tjerhiqet dorëshkrimi i paraqitur per botim dhe anëtarit të stafit të fakultetit të vlerësuar nuk i lejohet të udhëheqë master ose doktorat për, së paku 3 vjet.
4. Për Plagjiature të *Nivelit të Lartë*: Dëshmi e qëllimshme dhe e planifikuar për të kopjuar punën e bërë nga dikush tjetër. Një sasi e madhe e të dhënave të marra nga puna e dikujt tjetër, kopjimi i tabelave, figurave, skemave, kopjimi pa asnje referencë. Synimi për të mashtruar është shumë i qartë. Ngjashmëria midis dokumenteve është jashtë kufirit (mbi 60%). Komisioni i rekandonton punëdhënësit (zyrave respektive) masa administrative deri në largim nga puna.

#### **Neni 18. Procedura e ankesave**

1. Të gjithë ata që janë të përfshirë në edukimin shkencor dhe kërkimin brenda Universitetit Bujqësor kanë përgjegjësi për ruajtjen e integritetit shkencor.
2. Qëllimi i ketij nenit është të sigurojë sa më shumë që të jetë e mundur, se çdo njësi akademike zbaton të njëjtën procedurë për trajtimin e shkeljeve të dyshuara të integritetit shkencor.
3. Çdo person që merret me ankesat ose dyshimet për shkelje të integritetit do të përdorë të njëjtat parime themelore, terminologji dhe procedura.



### Neni 19. Trajtimi i Ankesave dhe Ndaruja e Përgjegjësive

Një nga masat mbrojtëse të integritetit shkencor është e drejtë për t'u ankuar për shkeljet ose shkeljet e dyshuara të integritetit shkencor nga punonjësit e Universitetit Bujqësor. Për të konkretizuar këtë të drejtë për t'u ankuar, rregullorja parashikon sa më poshtë:

1. Ankesat fillimisht paraqiten tek KIAU.
2. Komisioni vlerëson pranueshmërinë e ankesës në bazë të kritereve të mëposhtme:
  - një përshkrim të qartë të shkeljes ose të shkeljes se dyshuar të integritetit shkencor nga punonjësi;
  - përfshirjen e dokumenteve përkatëse me shkrim ose formave të tjera të provave;
  - përfshirjen e emrit, pozitës dhe informacionin e kontaktit të ankuesit;
  - praninë e një date.
3. KIAU adreson ankesën te Përgjegjesi i Departamentit / KIAD, ose te/KIAF.
4. Në rast se Përgjegjësi i Departamentit, është i lidhur në ndonjë mënyrë me personat ose faktet të cilët janë objekt i pyetjeve ose ankesave, ai nuk ka të drejtë të merren me trajtimin e kesaj ankese dhe kjo ankesë kalon direkt në komisionin e Departamentit.
5. Pas një diskutimi për pyetjen /ankesën, Përgjegjësi i Departamentit vlerëson situatën dhe ofron këshilla për veprimet e duhura ndjekëse.
6. Këto veprime përcjellëse mund të përbëhen nga ndërmjetësimi nëpërmjet Përgjegjësit të Departamentit, ose referimi tek Komisioni.
7. Nëse përfshihet ndonjë mashtrim, ose nëse Përgjegjësi i Departamentit dyshon për elemente të mashtrimit, ai ia raporton KIAU-t dhe i këshillon palët e përfshira që ta raportojnë atë tek KIAD/KIAF.

### Neni 20: Procedura të përzgjedhjes së Komisioneve

1. Për të trajtuar ankesat lidhur me shkeljet e integritetit shkencor në kërkimin shkencor, Senati i Universitetit ngrë Komision i Integritetit Akademik të Universitetit (KIAU).
2. Komisioni përbëhet nga shtatë anëtarë, një përfaqësues nga çdo njësi kryesore, që përzgjidhen nga Senati Akademik, një anëtar i jashtëm (me titull "Profesor") i përzgjedhur nga Rektori dhe Përgjegjësi i Zyrës së Kërkimit.
3. Anëtarët e KIAU zgjidhen nga Senati Akademik për një periudhë katër vjeçare. Në fund të mandatit, anëtarët mund të rizgjidhen për një periudhë tjeter katër vjeçare.
4. Komisioni i Integritetit Akademik të Fakultetit (KIAF) zgjidhet nga Asambleja Akademike e Njësisë kryesore dhe përbëhet nga pesë anëtarë.
5. Komisioni i Integritetit Akademik të depatrmentit (KIAD) zgjidhet nga departamenti dhe përbëhet nga pesë anëtarë.
6. Gjatë procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit, Senati duhet të përpinqet të arrijë një përfaqësim të balancuar të fushave kryesore shkencore që mbulon Universiteti Bujqësor.
7. Për qëllime të hetimit të një Ankese të veçantë, mund të caktohen ekspertë (qoftë të lidhur me Universitetin Bujqësor, ose të pavarur) të cilët mund ti bashkohen përkohësisht Komisionit.

### Neni 21: Komisionet-Autoriteti-Përgjegjësia

1. Me marrjen e ankesës nga KIAU, Komisioni i Departamentit KIAD/KIAF është i autorizuar të mbledhë informacionin e duhur. Ato mund të kërkojnë të inspektojnë të gjithë dokumentacionin dhe korrespondencën që e konsiderojnë të rëndësishme.



2. Komisioni mund të konsultohet me ekspertë, qoftë ato të lidhur me fakultetin përkatës, ose të pavarur. Në fund, komisioni duhet të hartojë një raport me gjetjet kryesore dhe rekomandimet përkatëse.
3. Komisioni mund t'i ofrojë ankuesit mundësinë për ta përpunuuar ankesën brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga Komisioni, nëse ajo nuk është e rregullt.
4. Nëse ankesa është shkruar në një gjuhë të huaj dhe kërkohet përkthim, për të trajtuar siç duhet Ankesën, Ankuesi është përgjegjës për marrjen e një përkthimi zyrtar.
5. Me kërkesën e Komisionit të Universitetit (KIAU), Komisioni i Departamentit (KIAD) dhe KIAF mund të hetojë një Ankesë pa e ditur identitetin e Ankuesit.
6. KIAD/KIAF duhet të arrijë në përfundim të pranueshmërisë të ankesës brenda tri javëve. Nëse konstaton se ankesa është e papranueshme, duhet të njoftojë menjëherë Komisionin e Universitetit (KIAU) trreh këtij fakti.
7. Nëse KIAD/KIAF konkludojnë se ankesa është e pranueshme, ato vazhdojnë me hetimin e përbajtjes.
8. Komisioni interviston të gjithë palat e përfshira në ankesë. Këto intervista duhet të regjistrohen në një raport.
9. Komisioni mund të intervistojë dëshmitarët dhe ekspertët që kanë lidhje dhe njoħuri me fushën.
10. KIAD/KIAF duhet ta paraqesin opinionin e tyre në KIAU lidhur me përbajtjen e ankesës, brenda dy mbëdhjetë javëve pas pranimit të ankesës. Komisioni mund ta zgjasë këtë afat edhe një herë deri në katër javë.

#### **Neni 23. Procedura pasuese**

1. KIAU harton opinionin e vet fillestar brenda katër javëve pas marrjes së konfirmimit nga KIAD/KIAF. Më pas, ai njofton me shkrim ankuesin dhe të akuzuarin përmendimin e tij.
2. Brenda gjashtë javëve nga marrja e njoftimit nga Komisioni i Universitetit (KIAU), Ankuesi, ose i Akuzuari mund të kërkojnë që këto ankesa të trajtohen mbështetur në Ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".
3. Nëse ankuesi, ose i akuzuari nuk paraqesin kërkesë brenda 6 javëve, KIAU shpall vendimin e tij përfundimtar mbi ankesën.
4. Nëse i Akuzuari ende është i punësuar në Universitetin Bujqësor, Komisioni i Universitetit (KIAU) i propozon Rektorit për masat e mundshme ose hapat e mëtejshëm që duhet të merren, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi dhe kontratën e punës.

#### **Neni 24. Mbrojtja e palëve të përfshira**

1. Paraqitja e një ankesë në përputhje me këtë rregullore nuk duhet të sjellë në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose të tërhorthë ndonjë pasojë negative për ankuesin, përvèç nese ai/ajo nuk ka vepruar në mirëbesim. Mos veprimi me mirëbesim përfshin, por nuk kufizohet vetëm në parashtrimin e ankesës për të dëmtuar qëllimi emrin e mirë, ose nderin e një personi. Kjo vlen edhe për dëshmitarët, ekspertët, Përgjegjësin e Departamentit dhe anëtarët e Komisionit.

#### **Neni 25. Data e hyrjes në fuqi**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në datën 20.07.2019 dhe zëvendëson të gjitha procedurat mëparshme lidhur me çështjet e integritetit shkencor).



**Neni 26 Dispozitat përfundimtare**

1. Kjo rregullore mund të citohet si "Sjellja me integritet në kërkimin shkencor dhe promovimin akademik në Universitetin Bujqësor të Tiranës" dhe publikohet në faqen e internetit të Universitetit Bujqësor të Tiranës.
2. Të gjitha Ankesat e pranuara dhe të hetuara nga Komisioni, Këshillat e Komisionit dhe mendimi i Komisionit të Universitetit, publikohen në formë anonime në faqen e internetit të UBT-së.

monographia / S. Sulaj, Ymer Muhi

